

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë/Dega e Letërsisë Shqipe
Titulli i lëndës:	LETËRSIA PARAMODERNE SHQIPE
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i tretë/Semestri V
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E martë/ Salla nr. 86/ Ora: 10-13 Ushtrimet: E hënë/ Salla 76/ Ora 10-12 E premte/Salla 86/ Ora 10-12
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Sabri HAMITI
Detajet kontaktuese:	Zyra nr. 84/b/ Tel: 044176095
Përshkrimi i lëndës:	<p>Ky kurs ua mundëson studentëve njohjen me letërsinë paramoderne shqipe, duke përfshirë këtu hetimin e rrymave, individualizimin në letërsinë shqipe, shfaqjen dhe konsolidimin e të gjitha formave letrare, si dhe kahjet e mendimit teorik-kritik për problemet e letërsisë, por edhe të kulturës nacionale në përgjithësi.</p> <p>Përveç kësaj, studentët do të pajisen me dije dhe shkathtësi, e cila do t'ua mundësojë hulumtimin, analizimin e studimin e pavarur të teksteve letrare.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi <i>Letërsia paramoderne shqipe</i> ka për synim që studentëve t'ua mundësojë njohjen, leximin, studimin dhe interpretimin e letërsisë shqipe duke e parë atë në shfaqjen, orientimin dhe kontekstin e saj letrar e kulturor.</p> <p>Përveç kësaj, do të hetohen fenomenet, kahjet dhe konstituimi i letërsisë paramoderne, për t'i shenjuar këto te format e poezisë, prozës dhe dramës shqipe. Një kujdes i shtuar do t'i kushtohet edhe informimit dhe hulumtimit në fushë të studimeve teorike-kritike të autorëve të kësaj kohe.</p> <p>Të gjitha këto qëllime të mësimdhënies do të shkojnë paralel me aplikimin e njohurive të marra në tekste, vepra e autorë të veçantë, duke u ndalur kryesisht tek ato vepra (letrare e teorike) që paraqesin majat e letërsisë shqipe në kuptimin tejtempral të nocionit.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Të njohë konceptet substanciale të zhvillimit të letërsisë, kryesisht në letërsinë shqipe2. Të njohë dhe dallojë format e strukturat letrare – prozë, poezi, dramë – në kuadër të shfaqjes dhe konsolidimit të tyre, si dhe rrymat e mendimit teorik e kritik për letërsinë dhe kulturën shqipe në përgjithësi3. Të arrijë të hartojë dhe zhvillojë analiza, interpretime, studime të pavaura për letërsinë, tekstet

	dhe autorët e veçantë në kuadër të lëndës, por edhe jashtë saj		
	4. Ta plotësojë korpusin e njohjes dhe studimit të letërsisë nacionale dhe ta shtojë kreativitetin hulumtues në fushën e shkencave humane në përgjithësi.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min	15	4
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgatitja përfundimtare për provim	8	2 ditë	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1 ditë	3
Projektet, prezantimet, etj.,			
Totali			179:25=7.16 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë seminarike, diskutime		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt 10% Detyrat dhe angazhimet e tjera 15% Vlerësimi i parë 5% Vlerësimi i dytë 5% Vlerësimi i tretë 5 % Provimi final 60%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Gaetano Petrota: <i>Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare</i> 2. <i>Shkrimtarë shqiptarë I, II</i> 3. Sabri Hamiti: <i>Letërsia moderne</i>		
Literatura shtesë:	1. Rexhep Qosja: <i>Asdreni – Jeta dhe vepra</i> 2. Grup autorësh: <i>Gjergj Fishta</i> 3. Mensur Raifi: <i>Fan S. Noli dhe Migjeni</i> 4. Sabri Hamiti: <i>Vetëdija letrare</i> 5. Ibrahim Rugova: <i>Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983</i>		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX
<i>Java e dytë:</i>	Orientimet kryesore dhe strukturat letrare
<i>Java e tretë:</i>	Letërsia pasromantike, kritike, paramoderne
<i>Java e katërt:</i>	Sistematika e studimit letrar
<i>Java e pestë:</i>	Vlerësimi i parë
<i>Java e gjashtë:</i>	Andon Zako Çajupi: 1. <i>Baba Tomorri</i> , 2. <i>Baba Musa lakuriq</i> , 3. <i>Pas vdekjes</i>
<i>Java e shtatë:</i>	Aleksandër Stavre Drenova: 1. <i>Rreze djelli</i> , 2. <i>Ëndrra e lotë</i> , 3. <i>Psallme murgu</i>
<i>Java e tetë:</i>	Faik Konica: 1. <i>Dr. Gjëlpera...</i> 2. <i>Një Ambasadë e Zulluve në Paris</i> , 3. <i>Kritika letrare</i>
<i>Java e nëntë:</i>	Gjergj Fishta: 1. <i>Lahuta e Malcís</i> , 2. <i>Mrizi i Zanavet</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	Gjergj Fishta: 1. <i>Anzat e Parnasit</i> , 2. <i>Juda Makabe</i> , 3. <i>Jerina ase Mbretnesha e Lulevet</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Midhad Frashëri: 1. <i>Hi dhe Shpuzë</i> , 2. <i>Naim Be Frashëri</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Fan S. Noli: 1. <i>Albumi</i> , 2. <i>Israilitë e Filistinë</i> , 3. <i>Autobiografia</i> , 4. <i>Introduktat</i>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Ligjëratë përmblylëse
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i tretë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti gjatë orëve të mësimit duhet ta respektojë etikën e punës duke mbajtur qetësinë dhe duke u përfshirë në mënyrë aktive në procesin mësimor.